

POLITIKAT NË FOKUS: MSA



Rreth publikimit 'Politikat në Fokus'

Në vitin 2016, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, ka filluar publikimin e dokumentit 'Politikat në Fokus' – i cili ka për synim të sjellë vëmendjen në politika të ndryshme ekonomike. Më tutje, ky dokument gjithashtu ka për qëllim të përmbledhë sfidat për zhvillimin e politikave të tilla në mënyrë që të hapet rruga drejt adresimit të tyre. Ky dokument do të publikohet në baza dy-mujore. Përderisa ky edicion i parë vë fokusin Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim (MSA) në Kosovë, edicionet e ardhshme do të jenë mbi politika të tjera me interes për sektorin privat.

Politikat në Fokus – Marrëveshja për Stabilizim Asociim (MSA)

Ky dokument paraqet një përmbledhje të MSA-së në Kosovë, me fokus në përbërjen e saj dhe implikimet në sektorin privat, ne veçanti dhe ekonominë e Kosovës ne përgjithësi.

Procesi i Stabilizim Asociimit (PSA) i udhëhequr nga BE në kuadër të politikave të zgjerimit, ka tri qëllime kryesore:

- i. Stabilizimi dhe transformimi i shpejtë në ekonominë e tregut;
- ii. Nxitja e bashkëpunimit rajonal
- iii. Perspektiva e anëtarësimit ne BE

Pjesë përbërëse e PSA-së është nënshkrimi i MSA-së ndërmjet BE-së dhe anëtarëve të mundshëm. Procesi është zhvilluar edhe në rajonin e Ballkanit, si dhe në Kosovë e cila është pjesëtarja e fundit e kësaj marrëveshje me BE-në. Seksioni pasues i këtij dokumenti paraqet një pasqyrë të MSA-së në Kosovë, duke përfunduar me një përmbledhje të PSA-ve dhe MSA-ve të shteteve të rajonit.

Pasqyrë e MSA-së Kosovë-BE

Si një marrëveshje ndërkombëtare, MSA përcakton mekanizmat zyrtare dhe afatet kohore për implementimin e të gjitha reformave të cilat në mënyrë progresive e lidhin Kosovën me BE-në në të gjitha fushat e politikave. Gjithashtu, MSA përcakton strukturën e marrëdhënieve të Kosovës me shtetet anëtare të BE-së dhe institucionet për implementimin e PSA-së derisa anëtarësimi i plotë në BE arrihet.

MSA Kosovë- BE krijon një marrëdhënie kontraktuale që përfshin të drejta reciproke dhe detyrimet dhe i mbulon të gjithë sektorët e biznesit dhe të ekonomisë. MSA fokusohet në parimet kryesore demokratike dhe elementet thelbësore që janë në zemër të tregut të vetëm të BE-së. Përmes MSA- e nënshkruar më 27 Tetor 2015- si Republika e Kosovës ashtu edhe BE kanë rënë dakord që të punojnë së bashku drejt përmirësimit të bashkëpunimit rajonal dhe krijimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore. Gjithashtu, palët janë përkushtuar për të vazhduar lehtësimin e lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, në bazë të koncesioneve të përbashkëta si dhe të jenë në përputhshmëri me Marrëveshjen e Përgjithshme për Tregtinë dhe Tarifatat (MPTT 1994) dhe Marrëveshjen e Përgjithshme për Tregtinë me Shërbime (MPTSh).

MSA vë theks të veçantë çështjeve në vijim:

- **Të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale:**

Për të garantuar një nivel i duhur i mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare njëjtë si ato ekzistuese në BE, duke i përfshirë mjetet efektive të zbatimit të të drejtave të tilla, Kosova do të ndërmarrë masat e nevojshme jo më vonë se pesë vite pas hyrjes në fuqi të MSA-së.

- **Lëvizja e lirë e të mirave dhe shërbimeve**

Pasi që MSA të hyjë në fuqi, BE dhe Kosova, gradualisht do të krijojnë një zonë të tregtisë së lire brenda një periudhe maksimale 10 vjeçare. Tarifatat të cilat do të konsiderohen si bazë për lirimet doganore janë ato të 31 dhjetorit të 2013-ës, duke përjashtuar tarifatat me zbritje, ku në këtë rast tarifatat e zbritura do të merren parasysh.

- **Mbrojtja e konkurrencës**

Si dy kriteret kryesore të MSA-së në aspektin e zhvillimit institucional, janë fuqizimi i pozitës së Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe Zyra për Ndihmë Shtetërore. Për sa i përket ndihmës shtetërore kërkohet raportim i rregullt për ndihmën e ofruar nga shteti drejt sektorit privat ose ndërmarrjeve publike, si dhe krijimi i një inventari të ndihmave brenda 3 vitesh.

- **Prokurimi publik**

Brenda 5 viteve që nga hyrja në fuqi e MSA-së, Kosova është e detyruar të heq të gjitha preferencat në aktivitetet e prokurimit publik për kompanitë e Kosovës ose kompanitë e BE-së të regjistruara në Kosovë, mbi bazën e mosdiskriminimit dhe reciprocitetit. Për më tepër, kompanive të Kosovës do t'u jepet qasje në procedurat e prokurimit publik në BE, me trajtim jo më pak të favorshëm sesa kompanitë e BE-së ("MSA Ndërmjet BE-së dhe Kosovës").

Synimet e MSA-së Kosovë - BE

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ka për qëllim të:

- Mbështesë përpjekjet e Kosovës për të fuqizuar demokracinë dhe sundimin e ligjit
- Kontribuojë në stabilitetin politik, ekonomik dhe institucional në Kosovë, si dhe në stabilitetin e rajonit
- Te sigurojë një kornizë të përshtatshme për dialog politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet palëve.
- Mbështesë përpjekjet e Kosovës për të zhvilluar bashkëpunimin e saj ekonomik dhe ndërkombëtar, duke përfshirë përafrimin e legjisllacionit me atë të BE-së

- Mbështesë përpjekjet e Kosovës për të përfunduar kalimin në një ekonomi funksionale të tregut
- Promovojë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe gradualisht të zhvillojë një zone të tregut të lire ndërmjet BE-së dhe Kosovës
- Nxsis bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat e përfshira në këtë marrëveshje.

Efektet e pritshme në të bërit biznes dhe në marrëdhëniet tregtare

Si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjes MSA-BE, Kosova dhe BE do të fillojnë themelimin gradual të zonës së tregtisë së lirë brenda 10 viteve, përmes heqjes së tarifave të tregtisë dhe pengesave jotarifore. Bizneset e Kosovës do të përballen me konkurrencë më të madhe në treg dhe do të përfitojnë nga liberalizimi gradual, duke pasur parasysh që disa produkte do të kenë masa mbrojtëse të përkohshme:

- 1,311 produkte do të liberalizohen gradualisht, brenda një periudhe 5 vjeçare;
- 925 produkte do të liberalizohen gradualisht brenda një periudhe 7 vjeçare;
- Tarifat doganore do të shfuqizohen për 3,023 linja tarifore të produkteve industriale; produkte për të cilat shteti jonë ka mungesë të kapaciteteve.

MSA do të sigurojë mbështetje për reformat ekonomike me qëllim të fuqizimit të qëndrueshmërisë makroekonomike dhe të stabilitetit, duke e përfunduar kështu procesin e tranzicionit drejt një ekonomie funksionale të tregut. Kjo do të arrihet përmes përafrimit të legjislacionit me *Acquis Communautaire* dhe po ashtu përmes mbështetjes së fuqizimit të sundimit të ligjit.

Në këtë aspekt, Kosova do të ketë mbështetje financiare dhe teknike nga BE-ja, të cilat do të shërbejnë për përmirësimin dhe përfundimin e kornizës ligjore dhe po ashtu përmirësimin e ambientit biznesor (Çollaku f.40).

Në tërësi, MSA pritet të ketë një ndikim shumë të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës- që është për të përmirësuar bilancin e vazhdueshëm negativ tregtar. Në përpjekjet për të analizuar efektet që MSA ka në këtë aspekt, është paraqitur shkëmbimi tregtar ndërmjet Kosovës dhe BE-se për muajt prill-qershor, për vitet 2014-2016. Megjithatë, duke qenë një periudhë mjaft e shkurtër, rezultatet mund të mos jenë edhe aq treguese të rezultateve aktuale për ekonominë.

Efektet e fillestare të MSA-së në bilancin tregtar të Kosovës

Nëse krahasohen shkëmbimet tregtare të Kosovës me BE-në për periudhën që fillon në Prill dhe përfundon në Qershor, për 2014-2016, trendet janë thuajse të njëjta. Përderisa për importe shihet një rritje më e shpejtë nga 2014 në 2015, në 2016 kemi një trend në ulje. Ngjashëm, edhe pse për importe, rritja ishte më e ngadaltë në 2015 krahasuar me 2014, në 2016 shohim një trend në ulje.




Figura 1: Shkëmbimi tregtar Kosovë-BE Prill-Qershor, 2014-2016

Në 2014 për periudhën Prill-Qershor eksportet në BE-28 arritën në 24,595 milionë euro; në 2015 arritën në 20,084 milionë euro ("Statistikat e Tregtisë së Jashtme"), kurse në 2016, nga koha kur MSA hyri në fuqi, eksportet u rriten në 1,562,300. Në anën tjetër, importet në 2014 ishin 270,858,000 në 2015 arritën në 294,863,000 por në 2016 u rriten në 278,598,543 euro ("Të Dhënat Komerciale Sipas Kodit Tarifor").

Udhërrëfytes për Eksport në BE

Për të lehtësuar shkëmbimet tregtare mes shteteve anëtare të BE-së dhe vendeve të tjera, Drejtorati i Përgjithshëm i BE-së për Tregti ka krijuar exporthelp.europa.eu – një ndihmesë në formë elektronike për eksport, që kompanitë mund t'a përdorin si burim të informatave për:

- Detyrime doganore,
- Kërkesa ligjore, dhe
- Rregulla të origjinës.

Kjo vegël elektronike u ofron bizneseve qasje në një listë të plotë të kërkesave që duhet të përmbushen në mënyrë që eksportet drejt shteteve anëtare të BE-së të mund të realizohen. Më tutje, kjo faqe gjithashtu i llogarit tarifën e importit për produkte specifike, duke ofruar informata mbi trajtime preferenciale që i gëzon produkti dhe llojin e tyre.

Në mënyrë që të mundësohet hulumtim sa më substancial i tregut, kjo uebfaqe ofron edhe të dhëna mbi shkëmbimet tregtare, për periudha specifike me të gjitha shtetet anëtare. Në vijim është paraqitur një ilustrim mbi atë se si 'ExportHelp' mund përdoret nga kompanitë për të lehtësuar eksportin.

Hapi 1: Vizitoni faqen: exporthelp.europa.eu

Hapi 2: Klikoni mbi "My export" (shq. Eksporti im)

Hapi 3: Plotësoni formën në vijim, me informata mbi kodin e produktit, destinacionin e eksportit, dhe vendin e origjinës.

My export

Enter a product code (10 digits) [Find my product code](#)

Select a country of origin ▼

Select a destination country ▼

Select a simulation date (DD/MM/YYYY)

[Search](#)

Një shembull me eksportin e mollëve nga Kosova në Austri është përdorur për qëllime të këtij publikimi.

Hapi 4: Qasuni informacionit

Nën 'kërkesat specifike' (ang. specific requirements), kompanitë kanë mundësinë të shohin se çka kërkohet nga shtetet anëtare në mënyrë që produktet të plasohen në tregun e tyre. Në shembullin tonë, shihet se Austria ka 8 kërkesa specifike në mënyrë që mollët nga Kosova të vendosen në tregun austriak.

Kompanitë mund të klikojnë mbi secilën kërkesë specifike në mënyrë që të marrin më shumë informacione se si duhet t'a përmbushin atë, si dhe informatat kontaktuese të institucioneve përkatëse.

My export

Requirements | **Tariffs** | Rules of Origin Stabilisation & Association Process

08081080 - From Kosovo (As defined by United Nations Security Council Resolution 1244 of 10 June 1999) / To Austria

Code	Product Description
08	EDIBLE FRUIT AND NUTS; PEEL OF CITRUS FRUIT OR MELONS
0808	Apples, pears and quinces, fresh
0808 10	--Apples
0808 10 10	--Cider apples, in bulk, from 16 September to 15 December
0808 10 80	--Other

Specific requirements for 08081080

- [Control of contaminants in foodstuffs](#)
- [Control of pesticide residues in plant and animal products intended for human consumption](#)
- [Health control of foodstuffs of non-animal origin](#)
- [Plant health control](#)
- [Traceability, compliance and responsibility in food and feed](#)
- [Labelling for foodstuffs](#)
- [Marketing standards for fresh fruit and vegetables](#)
- [Voluntary - Products from organic production](#)

Internal Taxes

	Rate	Notes	Revision Date
VAT	10%	Austria, EU	01/04/2016
Excise	-	Austria, EU	01/04/2016

Hapi 5: Informata mbi tarifaf

Nën 'tarifat' (ang. *Tariffs*) kompanitë mund të shohin llojin e tarifave që zbatohen kundrejt produkteve të tyre, si *erga omnes*, pra kundrejt të gjitha shteteve joanëtare në përgjithësi, ashtu edhe trajtimin preferencial për ndonjë vend të caktuar. Për shembull, Kosova gëzon tarifa 0% për eksport të mollëve në BE, si shihet në vijim.

ekonominë e Kosovës nëpërgjithësi, dhe sektorin afarist në veçanti, ekziston edhe një konsensus i përgjithshëm se nëse institucionet kryejnë detyrën e tyre në ofrimin e një ambienti pozitiv për zhvillim, atëherë kjo marrëveshje do të shërbejë si bazë për zhvillim ekonomik dhe fuqizim të sektorit privat.

Disa sfida kryesore të cilat mbetet të adresohen nga qeveria përfshijnë:

Qasjen në financa

Momentalisht, kompanitë kosovare kanë qasje të kufizuar në financa, me gjithë sektorin financiar kryesisht të përbërë nga bankat dhe disa institucione mikrofinanciare. Edhe nëse qasja në financa është e mundshme, atëherë kompanitë përballen me sfida në marrjen e financimit për qëllime specifike. Për shembull, sa i përket MSA-së, kompanitë që kanë nevojë të marrin standarde ose investojnë në kualitet, duhet të kenë mundësinë që të marrin kredi që shërbejnë për këtë qëllim specifik.

Edhe pse Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë është një iniciativë shumë e mirë drejt uljes së riskut duke mbuluar një pjesë të kolateralit, dhe kështu duke luajtur rol edhe në uljen e normave të interesit, ende mbetet shumë për t'u bërë në mënyrë që të lehtësohet qasja në financa dhe rrjedha e parasë në treg, ashtu që bizneset të jenë më shumë gati të përballojnë presionin e shtuar të tregut pas hyrjes në fuqi të MSA-së.

Code	Product Description
08	EDIBLE FRUIT AND NUTS; PEEL OF CITRUS FRUIT OR MELONS
0808	Apples, pears and quinces, fresh
0808 10	-Apples
0808 10 10	--Cider apples, in bulk, from 16 September to 15 December
0808 10 80	--Other
0808 10 80 10	---Cider apples

Origin	Measure Type	Tariff	Conditions	Footnote	EU Law
ERGA OMNES	Third country duty	Entry prices		PB001	R1754/15
ERGA OMNES Excluding: Argentina, Brazil, Chile, China, New Zealand, Saudi Arabia, South Africa, United States of America	Standard import value	117.1 EUR/100 kg			C0126/16
Kosovo (As defined by United Nations Security Council Resolution 1244 of 10 June 1999)	Tariff preference	0 %			R1336/11

Footnotes
PB001 Duty rate linked to entry prices system

Hapi 6: Rregullat e Origjinës

Nën 'Rregullat e Origjinës' (ang. *Rules of Origin*) paraqitet mënyra e aranzhimit të rregullave të origjinës për produktin që eksportohet, p.sh. akumulimi, toleranca, derogimi, etj.

HS heading	Description of product	Working or processing, carried out on non-originating materials, which confers originating status
Chapter 8	Edible fruit and nuts; peel of citrus fruits or melons	Manufacture in which: <ul style="list-style-type: none">all the fruit and nuts used are wholly obtained, andthe value of all the materials of Chapter 17 used does not exceed 30 % of the value of the ex-works price of the product

Sfidat dhe Rruga Përpara

Përderisa ekzistojnë dy mendime të ndryshme lidhur me atë se si MSA do të ndikojë

Infrastruktura e cilësisë

Një prej pengesave kryesore me të cilat përballen prodhuesit gjatë eksportit në vendet tjera është mungesa e standardizimit dhe infrastrukturës së institucionalizuar të cilësisë. Hulumtime të zhvilluara nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë me prodhues vendor sugjeron se një prej arsyeve kryesore se pse kompanitë mbesin të paimteresuara drejt investimit në infrastrukturë të cilësisë është kostoja e lartë e kësaj të fundit. Andaj, është e rëndësishme që qeveria të drejtojë asistencën teknike dhe financiare në këtë aspekt. Kjo veçanërisht duke pasur parasysh se jo shumë produkte mund të plasohen në tregun e përbashkët të BE-së nëse nuk pajisen me standardet e nevojshme dhe nuk prodhohen përmes proceseve kualitative.

Sigurimi i konkurrencës së drejtë dhe lokale

Konkurrenca e drejtë dhe lojale është pika kyçe një ekonomie funksionale të tregut të lirë. Në këtë drejtim, funksionalizimi i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës është ngritur si një nga hapat e parë që duhet ndërmarrë nga qeveria në mënyrë që forcat e tregut të veprojnë në një ambient të drejtë dhe të barabartë. Gjithashtu, bizneset të cilat përballen me konkurrencën e shtuar nga kompanitë e BE-së duhet të mbështeten (qoftë në formë teknike ose financiare).

Sfida lidhur me të drejtat pronësore intelektuale dhe industriale

Në aspekt të të drejtave pronësore intelektuale dhe industriale, Kosova nuk është një destinacion shumë i sigurt investimi. Shkelje hasen në të dyja fushat, dhe ka një mungesë të kapaciteteve për mbikëqyrje të tregut. Inspektorati i Tregut në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ka burime njerëzore

shumë të limituara dhe si rezultat e ka të pamundur të bëjë një punë më të mirë në identifikim dhe ndëshkim të shkeljeve. Më tutje, dinamika e ngadaltë me të cilën po ecën procesi i amendamentimit të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, do të bëjë edhe më të vështirë përmbushjen e obligimeve të Kosovës nën MSA, veçanërisht në aspekt të transpozimit të legjisllacionit të BE-së në atë të Kosovës.

Tregu i Punës dhe Boshllëku i Affësive

Rezultatet e politikave të tregut të punës të ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës nuk janë shumë inkurajuese. Shtylla e parë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, e hartuar nga Qeveria e Kosovës fokusohet në kapitalin njerëzor, me hapa konkret drejt përmirësimit të punësimit. Sidoqoftë, deri më tani nuk ka përmirësime të matshme. Bizneset vazhdojnë të ritheksojnë se aftësitë teknike mungojnë në treg, duke paraqitur kështu një pengesë për zhvillim të tyre, e cila do të ndihmonte rrjedhimisht të përballen me presionet e tregut të përbashkët të BE-së.

Mekanizmat në dispozicion për Bizneset e Kosovës

Në mënyrë që të adresohen sfidat e përmendura më lartë si dhe të përmirësohet konkurrueshmëria e bizneseve të Kosovës, qeveria në bashkëpunim me disa donatorë të huaj kanë filluar dizajnimin e disa mekanizmave mbështetës. Në këtë aspekt, një konsorcium i donatorëve ndërkombëtarë, si USAID, SIDA, etj., kanë bashkuar forcat për të ofruar financim për investime në infrastrukturë të cilësisë. Programi është krijuar për t'u ndihmuar kompanive që të marrin standardet ISO dhe të sigurojnë kualitetin e duhur.

Më tutje, së bashku me rrugën e Kosovës nëpër Procesin e Stabilizimit Asocimit, është edhe qasja në fondet e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA). Përderisa dy runde të fondeve IPA janë ndarë në mënyrë të suksesshme tek organizatat e ndryshme dhe bizneset. Pas hyrjes në fuqi të MSA-së, Kosova sërish do të përfitojë nga ky instrument që ka për qëllim të përgatisë bizneset kosovare për tregun e përbashkët të BE-së.

Qeveria ka filluar të marrë një rol më aktiv në adresimin e këtyre sfidave, dhe duhet të vazhdojë, në mënyrë që sektori privat i Kosovës të fuqizohet.

Procesi i Stabilizimit Asocimit tanimë është gati i përfunduar të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Në vijim është paraqitur një përmbledhje e PSA-ve dhe MSA-ve në vendet e rajonit, si dhe efektet që këto të fundit kanë pasur në ekonomitë e vendeve të caktuara.

MSA në Maqedoni

Republika e Maqedonisë është shteti i parë rajonal që nënshkroi MSA-në dhe shteti i parë në të cilin MSA ka hyrë në fuqi. MSA u nënshkrua më 9 Prill 2001. Zbatimi i MSA-së dhe Marrëveshja e Përkohshme në tregti dhe marrëdhëniet tregtare me BE-në kontribuuan në përshpejtimin e zhvillimit ekonomik të Maqedonisë dhe në prodhimin e saj industrial dhe bujqësor, si edhe ofrimin gjithnjë e më të rëndësishëm të shërbimit ("Dhjetë Vjet të Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit f.15).

Siç shihet në figurën 2, menjëherë pas hyrjes në fuqi të MSA-së, në 2014 eksportet e Maqedonisë në BE filluan gradualisht të rriten. Si rezultat i kësaj, shteti ka arritur që të risë eksportet në BE për gati katër herë, nga 1,020,999,028 në 2001 në 3,960,425,251 euro në 2015 ("Tregtia e jashtme e Republikës së Maqedonisë").



Figura 2: Eksportet dhe Importet në BE para dhe pas hyrjes në fuqi të MSA-së në Maqedoni

MSA në Mal të Zi

Mali i Zi miratoi Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit në Mars 2007. Mali i Zi ka përparuar në ndjekjen e përforcimit fiskal dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit.




Figura 3: Eksporti dhe importi Mal i Zi-BE

Tregtia e Malit të Zi po ashtu karakterizohet me një sasi më të vogël të importeve në krahasim me shtetet tjera rajonale, importe të cilat gradualisht zbriten pas miratimit të MSA-së. ("Mirror Analysis Summary Report").

Nga 2006 në 2015, importi është ulur për 50.8% pas një rritje në vitin 2007, ndërsa eksporti në vendet e BE-së është karakterizuar me ndryshime në këtë periudhë. Pas hyrjes në dfuqi të MSA-së, eksporti është dyfishuar në BE, ndërsa pas asaj eksporti gradualisht është ulur, si tregohet në figurën 3 ("Export Helpdesk Statistics").

MSA në Serbi

Në Shtator 2013 MSA ndërmjet BE-së dhe Serbisë hyri në fuqi. Në 2012, para themelimit të MSA-së në Serbi, eksportet në vendet e BE-së ishin 9,659,044,139 EUR. Pas hyrjes në fuqi të MSA-së, eksportet janë rritur për 2.8%. Rritja më e madhe e eksporteve në BE u ndje pas 2013-tës, kur eksportet shënuan 10,357,488,597 euro dhe në 2014 me 11,167,099,975 euro, që sugjeron një rritje prej 15.6% nga 2012 në 2015, si tregohet në figurën 4. Në anën tjetër, importet në 2012 ishin 5,053,010,389 euro dhe vazhduan të rriten. Në 2015 ato shënuan 7,901,355,844 euro ("Export Helpdesk Statistics").




Figura 4: Eksporti dhe Importi Serbi-BE

MSA në Shqipëri

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit në Shqipëri hyri në fuqi në Prill 2009. Sa i përket kriterëve ekonomike, Shqipëria bëri disa përmirësime

drejt një ekonomi funksionale e tregut. Shqipëria ruajti stabilitetin makroekonomik, vazhdoi me nivelizimin e borxheve dhe bëri hapa për të përmirësuar administrimin dhe mbledhjen e tatimeve. Sidoqoftë, rritja ekonomike u ngadalësua më shumë dhe deficit i llogarisë aktuale mbetet i madh, duke reflektuar konkurrueshmërinë e dobët. Si tregohet në figurën 5, në 2008, vlera e eksporteve të Shqipërisë në vendet e BE-së ishte 2,202,689,730 euro dhe vazhdoi të rritet në 2,526,861,286 euro në 2015, duke sugjeruar një rritje të eksporteve në BE pas hyrjes në fuqi të MSA-së. Importi, në anën tjetër, thuhet të dyfishuar pas nënshkrimit të MSA-së dhe ka shënuar një rritje prej thuhet 71% ("Export Helpdesk Statistics").




Figura 5: Eksporti dhe Importi Shqipëri-BE

References

Ten Years of the Enactment of the Stabilization and Association Agreement. 1st ed. Skopje: Secretariat for European Affairs (SEA), 2011. Print.

External Trade of the Republic of Macedonia. 1st ed. Republic of Macedonia State Statistical Office, 2014. Print.

Montenegro 2015 Report. 1st ed. Brussels: European Commission, 2015. Print.

Mirror Analysis Summary Report. 1st ed. Podgorica: Montenegro Statistical Office, 2015. Print.

Monthly Statistical Bulletin. 1st ed. Belgrade: Statistical Office of the Republic of Serbia. Print.

Albania Progress Report. 1st ed. Brussels: European Commission, 2014. Print.

Publications on Foreign Trade. 1st ed. Tirana: Albania Institute of Statistics. Print.

SAA Between The EU and Kosovo. 1st ed. Strasbourg: European Commission, 2015. Print.

Çollaku, Bekim. Impact of SAA On Kosovo's Economy. 1st ed. Pristina: American Chamber of Commerce in Kosovo, 2016. Print.

External Trade Statistics. 1st ed. Pristina: Kosovo Agency of Statistics. Print.

Commercial Data Under Tariff Code. 1st ed. Kosovo Customs. Print.